



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 30 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Tretë për Zgjatje të Afatit

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit

Felisiti Geri

Xhejms O'Kif

Mbrojtjes së Haxhi Shalës

Tobi Kadman

Xhon Kabën

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të rregullave 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 26 prill 2024, pasi i ishin miratuar dy kërkesa të mëparshme për zgjatje të afatit,² Mbrojtja e Ismet Bahtijarit ("z. Bahtijari" dhe "Mbrojtja") paraqiti një kërkesë me të cilën kërkonte zgjatjen e mëtejshme të afatit për plotësimin dhe dorëzimin e formularëve, ndër të cilët dokumentacionin mbështetës që duhej për t'i kërkuar ndihmë juridike Zyrës Administrative ("Kërkesa").³

2. Në mbështetje të Kërkesës, Mbrojtja parashtron se z. Bahtijari ka dorëzuar të gjitha dokumentet relevante dhe ka marrë dhe dokumente të tjera, por mungon një dokument për mbrojtësin, i cili duhet të jetë i disponueshëm javën e ardhshme.⁴ Mbi këtë bazë, Mbrojtja kërkon zgjatjen e afatit deri më 3 maj 2024 për dorëzimin e dokumentit që mungon.⁵

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, nëse tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të zgjasë ose të shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit.

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik. KSC-BC-2023-11, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 20 nëntor 2023, publik.

² *Shih* KSC-BC-2023-10, F00253, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit*, 15 prill 2024, publik; F00259, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Dytë për Zgjatje të Afatit*, 19 prill 2024, publik.

³ KSC-BC-2023-10, F00269, Mbrojtja e z. Bahtijari, *Parashtrim i Bahtijarit për Zgjatjen e Tretë të Afatit për Ndihmën Juridike*, 26 prill 2024, konfidencial.

⁴ Kërkesa, para. 2-3, 6-8.

⁵ Kërkesa, para. 1, 6.

4. Sipas rregullës 76 të Rregullores, kërkesat për zgjatje të afatit paraqiten në kohë, për t'i lënë panelit kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.

III. DISKUTIM

5. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Kërkesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar.⁶

6. Sa u përket arsyeve të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, që nga parashtrimet e fundit mbi këtë aspekt,⁷ Mbrojtja ka përparuar në përgatitjen e kërkesës për t'i kërkuar ndihmë juridike Zyrës Administrative. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në veçanti thekson se: (i) janë marrë dhe dorëzuar disa dokumente mbështetëse që mungonin; dhe (ii) janë bërë kërkesa për marrjen e informacionit që mungon.⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se dokumenti mbështetës që mungon duhet të jetë i disponueshëm javën e ardhshme.⁹ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përligjin zgjatjen e kërkuar të afatit.

⁶ *Shih* KSC-BC-2023-10, F00259, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Dytë për Zgjatje të Afatit*, 19 prill 2024, publik, para. 9(b).

⁷ *Shih* KSC-BC-2023-10, F00256, Mbrojtja e z. Bahtijari, *Parashtrim i Ndryshuar i Bahtijarit për Zgjatjen e Mëtejshme të Afatit për Ndihmën Juridike*, 19 prill 2024, konfidencial.

⁸ Kërkesa, para. 3, 5, 7.

⁹ Kërkesa, para. 6.

IV. VENDIM

7. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen të plotësojë dhe t'ia dorëzojë kërkesën me cilën kërkon ndihmë juridike Zyrës Administrative, si dhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake lidhur me të, deri **të premten, 3 maj 2024**; dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve F00255, F00256 dhe F00269, deri **të premten, 3 maj 2024**.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurë Paraprake

E martë, 30 prill 2024

Në Hagë, Holandë.